

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Autoritetit Kontraktues – KOMUNA FUSHË KOSOVË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **612-26-5143-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **“Sinjalizimi horizontal dhe vertikal (633-026-012-211)”**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

“TSR” Sh.P.K.

Rr. “Fehmi Lladrovci” nr. 99

Fushë Kosovë

12000

+383 (0)44 34 13 68

Marksim Malsijaj, Drejtor

info@tsr-ks.com

17.08.2026

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit

te prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

B05 Njoftimi për Kontratë & Dosja e Tenderit – 26.06.2026
B58 Njoftimi mbi Vendimin – 07.08.2026
Kërkesa për rishqyrtim – 11.08.2026
Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim – 12.08.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kërkesa për rishqyrtim – 11.08.2026
Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim – 12.08.2026

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmblylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 59 par. 4 i LPP.

**** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.**

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me datë 15.05.2026 AK ka publikuar njoftimin mbi vendimin përmes të cilit e ka rekomanduar për kontratë OE “Sinjal shpk & Inline Engineering shpk.”. Në rastin konkret

të ky GOE nuk ka arritur që të përmbushë kërkesat e DT. Prandaj në vendimin e AK është dashur që të njëjtët të eliminohen si të papërgjegjshëm.

PRETENDIMI NR. 1: GOE i rekomanduar për kontratë ka dështuar të plotësojë dhe dorëzoj me rregull aneksin 7 të DT që është deklarata për themelimin e GOE. Në fakt, GOE ka dorëzuar 2 dokumente të ndryshme për themelimin e konsorciumit mirëpo asnjëri dokument nuk përkon me formularin ka qenë dashur të plotësohet sipas aneksit 7 të dosjes së tenderit (DT). Duhet theksuar që mospërputhjet me formularin e aneksit 7 nuk janë thjeshtë teknike apo devijime të vogla mirëpo bëhet fjalë për mospërputhje esenciale. Si shembull, formulari i aneksit 7 (i cili është formular i miratuar nga KRPP dhe i detyrueshëm për të gjitha GOE), në pikën 3 kërkon që GOE të deklarojë emrin e liderit të grupit. Ndërsa te kjo pikë tenderuesi i rekomanduar shënon emrat e të dy anëtarëve të GOE. Në fund si lider i GOE nënshkruhet sinjal shpk. Pra jo vetëm që nuk është plotësuar si duhet formulari por është krijuar edhe konfuzitet. Ngjashëm vlen edhe te pika 5 ku formulari kërkon që të shënohen përqindjet e pjesëmarrjes në projekt të secilit anëtarë të GOE. Ndërsa këtu tenderuesi i rekomanduar (konkretisht te pika c) lëshohet edhe në detyrat dhe përgjegjësitë e njërit ose tjetrit anëtarë. Pra edhe kjo pikë është plotësuar gabim dhe krijon konfuzitet pasi që pika 5 dedikohet për përcaktimin e përqindjes së pjesëmarrjes ndërsa detyrat dhe përgjegjësitë duhet të elaborohen te pika 6 e formularit. Paradoksalisht tenderuesi e ka plotësuar gabimisht edhe pikën 6 pasi që (këtu kur është dashur të sqarohen detyrat dhe përgjegjësitë), tenderuesi ka deklaruar që “të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe vec e vec të obliguar dhe përgjegjës për tenderin...”. Pra konfuziteti qëndron te fakti se nuk dihet me cka do të merret njëri OE dhe me cka tjetri kur të njëjtë kanë përqindje të ndryshme të pjesëmarrjes dhe ofertojnë si GOE. Përderisa nuk janë specifikuar detyrat e sakta të njërit dhe anëtarit tjetër te kjo pjesë e formularit, atëherë edhe këtu nuk është plotësuar si duhet formulari. Sidoqoftë, edhe pa u lëshuar fare në përmbajtje nuk është kontestues fakti që tenderuesi i rekomanduar nuk e ka plotësuar aneksin 7 të DT. Kjo mund të vërtetohet edhe përmes faktit që aneksi 7 i DT i ka 3 faqe si formular i paplotësuar (që mund të shndërrohet eventualisht në 4 faqe pas plotësimit). Në anën tjetër tenderuesi ka dorëzuar 2 dokumente të emërtuara si marrëveshje të konsorciumit mirëpo njëra prej tyre i ka 2 faqe dhe tjetra vetëm 1. Në asnjërin prej tyre nuk shënohet “aneksi 7” për t’u identifikuar me formularin e bashkëngjitur me DT. Tutje janë bërë ndërhyrje në përmbajtjen e tekstit (tjetër përmbajtje ka formulari tjetër ka dorëzuar GOE). Natyrisht që dallon edhe fondi dhe stili i shkronjave dhe kështu me rradhë. Pra nuk do të duhej të ishte fare kontestues fakti që GOE nuk e ka plotësuar dhe dorëzuar si duhet deklaratën për themelimin e GOE sipas aneksit 7 të DT. Për këtë arsye AK duhet të eliminoj komplet ofertën si administrativisht të papërgjegjshme pasi që mungesa (mosplotësimi i duhur) i deklaratës për themelimin e GOE sipas pikës 10 të UPP është kusht administrative për të cilin AK nuk ka të drejtë as që të kërkoj sqarime shtesë.

PRETENDIMI NR. 2: Anëtari i GOE “Inline Engineering” nuk e ka dorëzuar deklaratën nën betim me nënshkrim autentik (original) nga personi përgjegjës. Përndryshe deklarata nën betim e këtij OE ka edhe të meta tjera pasi që është ndërhyrë në formularin e aneksit 2 të bashkëngjitur me DT. Konkretisht pjesa e titullit të aktivitetit të prokurimit dhe numri i aktivitetit nuk janë identike sikurse në formularin e aneks 2 në DT. Për këtë arsye vlerësojmë se AK nuk duhet të merr parasysh deklaratën nën betim të dorëzuar nga ky OE. Rrjedhimisht AK duhet të eliminoj komplet ofertën e GOE si administrativisht të papërgjegjshme pasi që mungesa (mosplotësimi i duhur) i deklaratës nën betim sipas pikës 10 të UPP është kusht administrative për të cilin AK nuk ka të drejtë as që të kërkoj sqarime shtesë.

PRETENDIMI NR. 3: Te kërkesa nr. 6 e DT në kuadër të kapacitetit teknik dhe profesional është kërkuar të dorëzohet autorizimi i prodhuesit. GOE ka dorëzuar 3 autorizime të ndryshme mirëpo asnjëri prej tyre nuk është për shtylla dhe perla të cilat janë të domosdoshme sipas DT. Përndryshe te njëri nga këto 3 autorizime (nga GEOSIGN) edhe titulli i aktivitetit të prokurimit është shënuar gabimisht dhe nuk është identik me titullin sipas DT (as në versionin anglisht).

PRETENDIMI NR. 4: Te stafi nuk janë dorëzuar dokumentet në mënyrë të rregullt sikurse janë kërkuar me DT. Fillimisht kontratat e punës nuk përputhen me listën e stafit të dorëzuar. Në asnjërin nga kontratat e punës të prezantuar nuk përcaktohet pozita e punës. Pra është lidhur një marrëdhënie e punës mirëpo nuk dihet se për cilën pozitë. Natyrisht që një kontratë e tillë është absolutisht e pavlefshme (nule). Ngjashëm vlen edhe sa i përket kohëzgjatjes së kontratave. Në titull thuhet se kontratat janë me afat të caktuar mirëpo nuk tregohet se për cilën periudhë kohore do të jenë të vlefshme ato. Përpos kontratave të punës, AK nuk duhet të pranojë as CV e prezantuar të punonjësve. Fillimisht duhet të sqarohet se CV janë dokumente personale të punonjësve dhe jo të kompanisë. Prandaj ato duhet të jenë të nënshkruara nga punonjësit ose duhet të ketë ndonjë formë tjetër për verifikimin e autenticitetit të tyre. Përtej kësaj, as CV nuk përputhen me listën e stafit të prezantuar sa i përket pjesës së përvojës së punës (tjetër përvojë rezulton sipas CV dhe tjetër sipas listës së stafit), pa çka se deklarimi i përvojës për secilin punonjës ka qenë kërkesë shprehimore në kërkesën nr. 2 të DT. Për më tepër, në Kërkesën nr. 2 të DT-së është përcaktuar qartë se OE duhet të ofrojë minimum 6 punëtorë, ndërsa në rastin e grupit të OE-ve, lideri duhet të ketë minimum 4 punëtorë. Ndërkaq, dy inxhinierët e kërkuar sipas pikave 2.1 dhe 2.2 janë kërkesa të veçanta dhe nuk mund të llogariten në numrin e punëtorëve të kërkuar sipas pikës 2. OE i shpallur fitues ka paraqitur listë me 9 persona, por në këtë listë përfshihen edhe dy inxhinierët, drejtori, menaxheri i biznesit – ekonomist dhe dy administratore. Kështu, në listë janë evidentuar vetëm tre persona si kryepunëtorë dhe punëtorë teknikë. Prandaj, OE nuk ka dëshmuar se i ka në dispozicion minimum 6 punëtorët e kërkuar, e as që lideri i grupit i ka minimum 4 punëtorët e kërkuar. Nëse këta punëtorë nuk kanë qenë në dispozicion të liderit, është dashur të siguroheshin nga anëtari tjetër i grupit, përfshirë edhe përmes parakontratave, nëse kjo lejohej nga DT-ja. Një dëshmi e tillë, megjithatë, nuk rezulton nga dokumentacioni i paraqitur. Për më tepër, DT-ja kërkon që njëri nga punëtorët të jetë i certifikuar si për Siguri dhe Shëndet në Punë, ashtu edhe për Mbrojtje nga Zjarri. OE fitues ka paraqitur vetëm certifikatën për Siguri dhe Shëndet në Punë, ndërsa nuk ka dëshmuar certifikimin për Mbrojtje nga Zjarri. Rrjedhimisht, OE i shpallur fitues nuk ka dëshmuar përmbushjen e kërkesave të DT-së as për numrin minimal të punëtorëve dhe as për certifikimin e kërkuar, prandaj oferta e tij nuk i përmbush kërkesat e përcaktuara në DT.

Nga sa u tha më sipër propozojmë që Paneli Shqyrtues të merr këtë:

VENDIM

MIRATOHET si e bazuar ankesa ashtu që aktiviteti i prokurimit kthehet në **RIVLERËSIM**.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Do të precizohen.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*